



Komiteti për Politikë dhe Financa

01.Nr.I

Deçan, dt.25.02.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e I-rë të rregullt të KPF-së, me dt.25.02.2025.

Në mbledhje merrnin pjesë: 7 anëtar të KPF-së, Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj, nga drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Antigona Dabiqaj, Zyrtarja për Informim, Edone Kameraj, OSBE.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPS-së, z.Hajdar Sutaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2025,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të KKS-së për vitin 2025,
4. Shqyrtimi i raportit të punës një vjeçare të Kryetarit të Komunës,
5. Shqyrtimi i raportit të punës një vjeçare të Komitetit të Komuniteteve,
6. Shqyrtimi i raportit analitik financiar për vitin 2024,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit të komisionit Komunal për emërim të rrugëve - Lista me emra rezervë të rrugëve të Komunës së Deçanit,
8. Shqyrtimi i kërkesave,
9. Të ndryshme

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e I-rë të rregullt të KPF-së për vitin 2025, verifikoj pjesëmarrjen e anëtarëve të KPF-së dhe konstatoj se 7 anëtarë të KPF-së janë të pranishëm në mbledhje, pastaj e prezantoi Rendin e punës, në vazhdim e hapi debatin rreth rendit të punës.

Meqenëse nuk kishte të lajmëruar për debat, Kryesuesi e qiti në votim rendin e punës, i njëjti miratohet njëzëri.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Vatan Istrefaj-kam një pyetje që nuk ka të bëjë me procesverbalin, pse nuk u mbajt mbledhja e muajit janar.

Kryesuesi- përgjigjet se sipas ligjit duhet të mbahen 10 mbledhje brenda vitit dhe e jona është që ta plotësojmë këtë kusht.

Njëzëri miratohet procesverbali pa vërejtje.

II. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2025.

Kryesuesi- e ka prezantuar këtë pikë pastaj e ka hapë debatin rreth saj.

Vatan Istrefaj- ka propozuar që në plan pune të hyn edhe Plani i KVRL-së në muajin Maj ose Qershor si dhe Raporti i Drejtorit të QKMF-së në Kuvendin Komunal një herë në vit.

Hyri Dobrunaj- ka shtruar pyetjen çka nënkupton me vizitë studimore të anëtarëve të kuvendit.

Yllarta Thaqi- ka propozuar që në muajin maj të hyn Raporti i Zyrës për Barazi Gjinore, si dhe Raporti I Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Komunale “Higjiena” Sh.A.

Kryesuesi- i ka qitë në votim propozimet një nga një dhe të gjitha janë miratuar.

Rekomandim: anëtarët e KPF-së pas shqyrtimit të kësaj pike, planin e dërgojnë në Kuvend për shqyrtim dhe miratim me propozimin që në muajin Maj të hyn edhe këto dy pika: Raporti I KVRL-së dhe Raporti I Zyrës për barazi gjinore, në muajin Korrik të hyn si pikë e rendit të ditës: Raporti I Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Komunale “Higjiena”

Sh.A, dhe në muajin Nëntor: Raporti i drejtorit të QKMF-së. Me këto propozime për ndryshimin dhe plotësimin e planit të punës së Kuvendit, njëzëri përcillet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

III.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të KKSBS-së për vitin 2025.

Kryesuesi- e ka prezentu këtë pikë pastaj e ka hapë debatin rreth saj.

Yllarta Thaqi-ka thënë, KKSBS është një organ i rëndësishëm, ndërsa sa i përket planit të punës së KKSBS-së nuk më pëlqen renditja e muajve, meqenëse ka kaluar janari, në vazhdim ajo ka propozuar që mbledhja e muajit Qershor të kalon në muajin Korrik, mbledhja e muajit Gusht të zhvendoset në fillim të muajit Shtator, mbledhja e muajit Dhjetor të kalon në muajin Nëntor. Në vazhdim ajo ka shtruar pyetjen, a kanë mëndu komuna me i pagua anëtarët e jashtëm të KKSBS_së, njëjtë sikur i paguajnë komunat tjera (Jo anëtarët e brendshëm), të paguhen personat e jashtëm që janë anëtarë të KKSBS-së.

Hyri Dobrunaj-shqetësim imi është kur thuhet në tetor, personat me aftësi të kufizuar, sipas meje kjo pikë nuk duhet me qenë hiq në plan sepse personat me aftësi të kufizuar nuk kanë qasje hiq.

Vatan Istrefaj- pyet, kush është zyrtari që e mbronë këtë pikë.

Kryesuesi- përgjigjet se këtë pikë e mbronë Antigona Dabiqaj sot, në vend të Gentiana Mazrrekaj.

Hyri Dobrunaj- thotë se nuk është përfshi tema për dhunë në familje, pastaj ka propozuar që në muajin Nëntor të debatohet rreth temës së dhunës në familje.

Rekomandim:KPF pas shqyrtimit të kësaj pike kanë rekomanduar që të bëhen këto ndryshime: Mbledhja e muajit Qershor të kalon në muajin Korrik, mbledhja e Gushtit të zhvendoset në fillim të muajit Shtator, ndërsa Dhjetori të zhvendoset në muajin Nëntor, poashtu në muajin Nëntor të debatohet rreth temës së dhunës në familje. KPF njëzëri e përcjellin për shqyrtim dhe miratim në kuvend Planin e punës së KKSBS-së për vitin 2025 me rekomandimin për ndryshimin dhe plotësimin e tij, të cekur si më lartë.

IV.Shqyrtimi i raportit të punës një vjeçare të Kryetarit të Komunës.

Rekomandim: KPF këtë pikë e përcjellin për shqyrtim në Kuvend pa debat, atje do ta japin kontributin e vet, çdo njëri nga anëtarët e kuvendit, ku do të jetë prezent Kryetari i Komunës.

V.Shqyrtimi i raportit të punës një vjeçare të Komitetit të Komuniteteve.

Vatan Istrefaj- ka shtruar pyetjen , qysh është gjendja e përgjithshme në teren e komuniteteve, duke nënkuptuar gjendjen financiare dhe gjendjen shëndetësore të komuniteteve.

Shkelzen Berisha, kryesues i komitetit të Komuniteteve – është përgjigjur se gjendja financiare e komuniteteve jo shumicë është e dobët por edhe gjendja e arsimit është bukur e dobët.

Yllarta Thaqi- te vizita në shkolla të sqarohet pse nuk e vijnë mësimin fëmijët e komuniteteve.

Shkelzen Berisha- përgjigjet se si deklarohen komunitetet lidhur me mos vijueshmërinë e mësimit nga fëmijët e tyre, thojnë nuk kemi kushte, ne jemi mundu me ndiku në këtë drejtim, por nuk kemi pasur shumë sukses ka thënë ai.

Florim Mataj- thotë se në shumicën e lokaliteteve në komunën tonë i kanë kushtet e mira, siç janë infrastruktura është, por edhe kombi busin për vajtje ardhje në shkolla e kanë, por konkret në cilat lokalitete ka probleme, pyet ai.

Hyri Dobrunaj- mu më intereson në teren si shkon puna, a kini ba kërkesë për përkrahje buxhetore, kërkesë e specifikume mu futë në planifikim të buxhetit.

Shkelzen Berisha- na i kemi ba kërkesat por disa janë marrë parasyshtë e disa jo. Ne jemi angazhuar me mundësitë tona, kemi mbajtë edhe mbledhje të jashtëzakonshme, i kemi thirre edhe Qendrën për punë Sociale, por nuk mund ti detyrojmë me zor me shku në shkollë

Hyri Dobrunaj- është mirë me i ditë kërkesat cilat janë dhe sa janë realizu ato.

Kryesuesi i KPF-së- na po dojmë që të gjithë me qenë të barabartë- të gjitha komunitetet.

Rekomandim: anëtarët e KPF-së e kanë shqyrtuar këtë pikë dhe njëkohësisht i kanë shtruar një varg pyetjesh, Kryesuesit të Komitetit, z,Shkelzen Berisha, pyetjet e shtruara janë: si është gjendja e

përgjithshme në teren e komuniteteve, gjendja financiare, arsimore, shëndetësore etj, është kërkuar konkret në cilat lokalitete janë të theksuara problemet e tyre, a është bërë kërkesë e specifikuar për tu futë në planifikim buxhetor përkrahja e komuniteteve jo shumicë. Pas shtrimit të pyetjeve, përgjigje ka dhënë kryesuesi i Komitetit të Komuniteteve, Shkelzen Berisha, i cili ka thënë se ne jemi angazhuar e sidomos për vijimin e mësimit nga nxënësit e këtij komuniteti por sukcesi ka qenë i vogël, KPF pas shqyrtimit raportin e përcjellin për shqyrtim në Kuvend.

VI.Shqyrtimi i raportit analitik financiar për vitin 2024.

Kryesuesi- e ka prezentu këtë pikë pastaj për sqarime fjalën ia kalon drejtoreshës së drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj, e cila ka thënë se ky raport nuk ka shumë ndryshime nga raporti 9 muajor për arsye se në tre muajt e fundit nuk kemi pasur shumë pagesa se nuk kemi pasur buxhet, ajo po ashtu ka sqaruar se në raport janë dy tejkalime te buxhetit.

Hyri Dobrunaj- ka pyet, cilin projekt kapital e keni zhvillu meqenëse me përmbaues janë marrë mbi 4 milion euro, pastaj ka kërkuar sqarim për shpenzimet brenda dhe jashtë vendit- 125,972.00 euro dhe q far të mirash i kanë sjellë komunës me vizitat e kryera nga jashtë vendit. Nëse përmbauesi i ka marrë mbi 4 milion sa është shuma e mjeteve financiare të cilat komuna ju ka pagua përmbauesve në këto pagesa.

Drejtoresha, Dafina, sqaron se shuma mbi 4 milion të cilat janë shpenzuar me përmbaues nuk janë vetëm nga kategoria e kapitaleve por ata na i kanë marrë ne mjetet aty ku kanë gjetë në të gjitha kategoritë Ndërsa sa ju përket shpenzimeve brenda dhe jashtë vendit të gjitha janë të sqaruara në arsyetimin që ju është bashkëngjitur çdo lande dhe këte mund ta shifni.

Yllarta Thaqi- sa automjete i ka komuna që po shkrinë këtu riparime të automjeteve, si dhe kompensimi brenda dhe jashtë vendit, çka nënkupton

Drejtoresha Dafina- sqaron se te riparimi i automjeteve hyjnë të gjitha kerret duke përfshi ato të QKMF-së dhe të zjarrfikësve.

Vatan Istrefaj- shërbimet këshillëdhënëse, shërbimet e veçanta, drekat zyrtare, kompensim përfaqësimi brenda vendit, përmbauesit, kërkon sqarim edhe te marrja e mjeteve me përmbaues te shëndetësia primare.

Drejtoresha Dafina- sqaron se shërbimet këshillëdhënëse janë pagesat e komisioneve, shërbimet e veçanta janë kontratat në vepër, te vendimet gjyqësore ma së shumti mjetet e marra me përmbaues janë për shujta të mësimdhënësve.

Vatan Istrefaj- pyet drejtoreshën në çfarë forme e ki publiku raportin në ueb faqen zyrtare.

Drejtoresha- përgjigjet se është i publikuar në të dy format.

Florim Mataj-është mirë që ata e kanë realizu ni të drejtë por kostoja e përmbauesve është shumë e lartë.

Hyri Dobrunaj- sa është shuma e shpenzuar për kontratën kolektive dhe shujtave të mësimdhënësve brenda vitit saktë.

Drejtoresha, Dafina përgjigjet se këto shënime janë te avokati i komunës.

Hyri Dobrunaj- rruga Qendra a është financim i komunës apo i ministrisë.

Drejtoresha Dafina- përgjigjet se rruga Qendra është bashkëfinancim Komunë-Ministri.

Huri Dobrunaj- thotë se tash asamblistet nuk kanë nevojë mu pagu në komisione sepse i kanë pagat e mira tash., si dhe pyet a është borgji i komunës 4mil. e 800mi apo më i madh.

Drejtoresha Dafina- është i publikuar në ueb faqe zyrtare.

Rekomandim: Anëtarët e KPF-së e kanë shqyrtuar këtë pikë dhe i kanë shtruar një varg pyetjesh, siq janë: cili projekt kapital ka arritë me u realizu në 2024, pasi që përmbauesi i ka marrë mbi 4 milion euro gjatë vitit 2024 kurse të planifikuara për kapitale kanë qenë më pak se kjo shumë, kanë kërkuar sqarim për

pozicionin, shpenzimet brenda dhe jashtë vendit, kanë kërkuar sqarim sa automjete i ka komuna meqenëse këtu është pozicioni i shpenzimeve-Riparimi i kerreve, sqarim kërkojnë për, shpenzimet këshillëdhënëse, për shërbimet e veçanta, sa është në total borgji i mbetur i komunës e të tjera.

Drejtoresha, Dafina Cacaj, ka dhënë sqarime për të gjitha pyetjet e ngritura, në fund PPF e përcjellin raportin për shqyrtim në Kuvend.

VII.Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit të komisionit Komunal për emërim të rrugëve - Lista me emra rezervë të rrugëve të Komunës së Deçanit.

Kryesuesi i Kuvendit, Hajdar Sutaj njëherit edhe kryesues i Komisionit për emërim të rrugëve ka sqaruar detajisht për punën e bërë nga komisioni, po ashtu ka njoftuar se komisioni i ka përgatitë listat me emra të rrugëve në bazë të kërkesave që kanë ardhë nga qytetarët dhe i kemi dërgua në Prishtinë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ata i kanë shqyrtua të gjitha dhe na kanë kthye listën bashkë me rekomandimet për plotësim të kriterëve të çdo emri për tu futë në listë ose mos plotësimin e kriterëve për të cilat një emër duhet të largohet nga lista, në fund lista të cilën e kini marrë ju është lista që na është miratua në Prishtinë.

Yllarta Thaqi- a janë emërim i rrugëve të reja apo ndryshim i emrave.

Kryesuesi- përgjigjet se janë vetëm emërim i rrugëve të reja.

Florim Mataj- e ngriti problemin e tabelave të rrugëve për të cilat ka kërkuar që të vendosen si dhe ka kërkuar sqarim se a ka ndonjë fond buxhetor për këtë çështje.

Drejtoresha Dafina përgjigjet po kemi fondin buxhetor dhe do ti rregullon këto Drejtoria e Shërbimeve publike.

Hyri Dobrunaj- pse është vetëm një emër grua dhe a ka mundësi mu shtua numri i emrave gra.

Rekomandim: KPF e kanë shqyrtuar këtë temë, për të njëjtën ka dhënë sqarime Kryesuesi i Komisionit , z.Hajdar Sutaj, ai ka thënë se komisioni ka punuar mjaft gjatë për këtë temë duke dalë në teren dhe verifiku gjendjen për çdo kërkesë të paraqitur, pastaj e kemi përgatitë listën me emra të rrugëve dhe e kemi dërgua në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ata e kanë studiua çdo emër të propozuar dhe i kanë dhënë vlerësimet e tyre për çdo propozim për rrugë e cila i plotëson kushtet dhe duhet të hyn në listë dhe për çdo propozim tjetër e cila nuk i plotëson kushtet ligjore dhe duhet të largohet nga lista si emër. Tash lista aktuale me emra për rrugë vetëm të reja e ka marrë miratimin e Agjencisë dhe vetëm duhet të del në Kuvend për miratim. Pas pyetjeve të ngritura dhe sqarimeve të dhëna nga kryesuesi, anëtarët e KPF-së e përcjellin pikën për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

VIII.Shqyrtimi i kërkesave.

Kryesuesi- sqaron se i kemi dy kërkesa:

1.Kërkesa e Alban Berisha për rregullim të kulmit të shtëpisë për të cilin është marrë vendim në gusht të vitit kaluar por nuk është ekzekutuar ende.

Drejtoresh Dafina thotë se nuk ka nevojë të përsëritet miratimi i kësaj kërkesë sepse ka hy në obligime të këtij viti dhe tash ekzekutohet.

2.Kërkesa e Endrit Januzaj në shumën 5000 euro për shërbime mjekësore.

KPF njëzëri e miratojnë kërkesën e Endrit Januzaj në shumën 5000 euro.

Vatan Istrefaj pyet a ka ndonjë kërkesë tjetër që ka ardhë në komunë por nuk ka dalë në KPF për të cilën kryesuesi përgjigjet se në dijeninë e tij nuk ka.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse

Dyke Lloluni



Kryesuesi i KPF-së
Hajdar SUTAJ

